

Separatorët e përbërë të papastërtive me magnet DIRTMAG®



Seria 5453



Funksioni

Separatori i papastërtive ndan papastërtitë që përbëhen kryesisht nga rërë dhe mbetje ndryshku, të cilat qarkullojnë brenda sistemeve të qarkut të mbyllur me shumë pak rënie presioni. Papastërtitë mblihen në një dhomë të madhe dekantimi, gjë që kërkon procedura pastrimi me frekuencë të ulët, nga të cilat ato mund të hiqen edhe ndërsa sistemi është në punë e sipër.

Separatorët e papastërtive DIRTMAG® janë gjithashtu të pajisur me një unazë magnetike të çmontueshme për ndarjen e papastërtive ferroze. Prodhuar me një material të përbërë të projektuar specifikisht për t'u përdorur në sistemet e kondicionimit të ajrit, ky separator papastërtish është shumë praktik pasi mund të instalohet si në tuba horizontale ashtu edhe vertikale.



Gama e produkteve

- Kodi 5453. Separatori i papastërtive DIRTMAG® me material të përbërë me magnet për tuba horizontale dhe vertikale me lidhje të filetuar _____ me përmasa DN 20 (3/4") dhe DN 25 (1")
- Kodi 5453. Separatori i papastërtive DIRTMAG® me material të përbërë me magnet për tuba horizontale dhe vertikale me rekorderi ulliri _____ me përmasa DN 20 (Ø 22) dhe DN 25 (Ø 28) me rekorderi për tubin prej bakri
- Kodi 5453. Separatori i papastërtive DIRTMAG® me material të përbërë me magnet për tuba horizontale dhe vertikale me valvula mbyllëse _____ me përmasa DN 20 (3/4"), DN 25 (1") dhe DN 32 (1 1/4")

Specifikimet teknike

Materialet

Trupi:	PA66G30
Mbulesa e separatorit të papastërtisë:	PA66G30
Tapa e sipërme:	tunxh EN 12164 CW614N
Vida e pastrimit:	tunxh EN 12164 CW614N
Dadoja mbyllëse për bashkuesen T:	PPSG40
Bashkuesja T:	
- kodi 545305, 545306, 545302 dhe 545303:	tunxh EN 1982 CB 753S
- kodi 545345, 545346 dhe 545347:	PA66G30
Elementi i brendshëm:	HDPE
Guarnicione hidraulike:	EPDM
Rubinet shkarkimi me lidhje tubi:	tunxh EN 12165 CW617N
Valvuli mbyllës:	
- kodi 545345, 545346 dhe 545347:	tunxh EN 12165 CW617N


Performanca

Lënda:	ujë, solucione glikoli
Përqindja maksimale e glikolit:	30 %
Presioni maksimal i punës:	3 bar
Intervali i temperaturës së punës:	0-90 °C
Induksioni magnetik i sistemit unazor:	2 x 0,3 T

Lidhjet

Trupi:	3/4", 1" F (ISO 228-1)
	Ø 22 - Ø 28 mm për tubin prej bakri
	3/4", 1", 1 1/4" F (ISO 228-1) me valvula mbyllëse

Dimensionet



Kodi	DN	A	B	C	C'	C''	D	E	Pesha (kg)
545305	20	3/4"	87,5	96	-	-	172,5	65,5	1,5
545306	25	1"	87,5	141	-	-	172,5	65,5	1,5
545302	20	Ø 22	87,5	-	115	-	172,5	65,5	1,5
545303	25	Ø 28	87,5	-	117	-	172,5	65,5	1,5
545345	20	3/4"	106,5	-	-	214	172,5	65,5	1,2
545346	25	1"	106,5	-	-	221	172,5	65,5	1,3
545347	32	1 1/4"	106,5	-	-	243	172,5	65,5	1,4

Parimi i punës


Parimi i punës së separatorit të papastërtive me magnet bazohet në veprimin e kombinuar të një sërë fenomenesh fizike.

Elementi i brendshëm (1) konsiston në një sërë sipërfaqesh rrjetë. Papastërtitë në ujë, kur përplasen me këto sipërfaqe, ndahen dhe bien poshtë në fund të trupit (2) ku mbledhen.

Papastërtitë ferroke kapen gjithashtu brenda trupit të separatorit të papastërtive, falë veprimit të dy magnetëve (3) të futur në një unazë të jashtme të posaçme të çmontueshme.

Vëllimi i madh i brendshëm i DIRTMAG® ngadalëson shpejtësinë e fluksit të mediumit, duke ndihmuar kështu, përmes gravitetit, ndarjen e mbetjeve në të.

Papastërtitë e mbledhura shkarkohen, edhe kur sistemi është në punë, duke hapur rubinetin e shkarkimit (4).



Detajet e ndërtimit

Teknopolimeri

Separatori i papastërtive është prodhuar me një teknopolimer të zgjedhur posaçërisht për proceset ngrohëse dhe ftohëse të sistemit. Karakteristikat kryesore të teknopolimerit janë:

- forcë e madhe filtrimi duke mbajtur një kapacitet të mirë zgjatës
- qëndrueshmëri e mirë ndaj përhapjes së krisjeve
- thithje shumë e ulët e lagështirës, për reagime mekanike konsistente
- rezistencë e lartë ndaj gërryerjes për shkak të rrjedhës së vazhdueshme të mediumit
- performancë e ruajtur sipas ndryshimit të temperaturës
- përputhshmëri me glikolet dhe aditivët e përdorur në qarqe.

Këto karakteristika bazë të materialit, të kombinuara me formën e përshtatshme të pjesëve që i nënshtrohen më shumë presionit, na mundësojnë krahasimin me metalet që përdoren zakonisht në ndërtimin e separatorëve të papastërtive.

Reduktimi i rënieve të presionit dhe ruajtje e performancës në kohë

Performanca e lartë e separatorit të papastërtive bazohet në përdorimin e elementit të brendshëm me sipërfaqet rrjetë. Parimi i përplasjes dhe dekantimit të mbetjeve e bën veprimin e separatorit të papastërtive më efikas krahasuar me filtrat e zakonshëm. Kjo performancë është konstante në kohë, ndryshe nga filtrat e zakonshëm që bllokohen nga llumi i mbetur, duke ndryshuar kështu veçoritë funksionale.

Struktura gjeometrike dhe dhoma e madhe e mbledhjes së papastërtive

Dhoma e mbledhjes së papastërtive ka veçoritë e mëposhtme:


- ndodhet në pjesën e poshtme të pajisjes, në distancë të tillë nga lidhjes që papastërtitë e mbledhura të mos ndikohen nga lëvizjet rrotulluese të rrjedhës nëpër rrjetë;
- është mjaftueshëm e madhe për të rritur sasinë e papastërtive të mbledhura, që nënkupton se kryerja e procedurave të boshatisjes/shkarkimit nevojitet shumë më rrallë (ndryshe nga filtrat që duhen pastruar shpesh);
- Inspektohet lehtësisht duke e zhvendosur atë nga trupi i valvulës për shërbimin e elementit të brendshëm, në rast bllokimi me fibra ose mbetje të mëdha

Ndarja e papastërtive ferroke

Seria e separatorëve të papastërtisë, të pajisur me një magnet, ofrojnë efikasitet të lartë në ndarjen dhe mbledhjen e papastërtive ferroke. Këto papastërti kapen brenda trupit të separatorit të papastërtive përmes fushës së fortë magnetike të krijuar nga magnetet e futur në unazën e jashtme të posaçme.




Unaza e jashtme mund të hiqet gjithashtu nga trupi për të lejuar dekantimin e tyre dhe më pas nxjerrjen jashtë, ndërkohë që sistemi është në punë.

Duke qenë se unaza magnetike është e vendosur jashtë trupit të separatorit të papastërtive, karakteristikat hidraulike të pajisjes nuk ndryshojnë.




Rregullimi i trupit në tubat horizontale dhe vertikale

Falë bashkueses së posaçme midis dados mbyllëse dhe elementit T, separatori i papastërtive DIRTMAG® mund të rregullohet (1) për instalimin në tuba horizontale (2) dhe vertikale (3) ose me 45°, duke ruajtur të njëjtat karakteristika pune.



Karakteristikat hidraulike



DN	20			25		32	
Lidhjet	Ø 22	3/4"	3/4"	Ø 28	1"	1" 1 1/4"	
Kodi	545302	545305	545345	545303	545306	545346	545347
Kv (m ³ /h)	9,5	10,3	7,5*	10,6	10,5	7,5*	9,9*


*Meme valvula mbyllëse

Shpejtësia maksimale e rekomanduar e rrjedhës tek lidhjet e pajisjes është ~1,2 m/s. Tabela e mëposhtme tregon shpejtësitë maksimale të rrjedhës, për pëmbushjen e këtij kriteri.

	l/min	m ³ /h
DN 20	21,67	1,3
DN 25	21,67	1,3
DN 32	35	2,1


Instalimi

Separatori i papastërtive duhet të instalohet në përputhje me drejtimin e rrjedhës, siç tregohet përmes shigjetës në elementin T, dhe mundësisht, në rrjedhën e sipërme të qarkut të kthimit të boilerit. Separatori i papastërtive duhet të instalohet gjithmonë në rrjedhën e sipërme të pompës dhe gjithmonë me trupin në pozicion vertikal.






Vrimat e ajrit

Përdorni një kaçavidë ose çelës flutur për të zhvidhosur vidën në tapën e sipërme dhe nxirri ajrin që mund të jetë mbledhur në pjesën e sipërme të trupit.



Shkarkimi i llumit

Hiqni unazën tek e cila janë vendosur magnetet (1) dhe kulloni papastërtitë, edhe kur sistemi është në punë, duke përdorur çelësin e posaçëm të marrë në dorëzim (2).




Mirëmbajtja

Në rastin e mirëmbajtjes në dhomën e mbledhjes së papastërtive, mjafton të zhvidhosi mbulesën e sipërme përmes çelësit të marrë në dorëzim, më pas të nxirri elementin e brendshëm, i cili është bashkëngjitur në mënyrën e duhur për t'u hequr për pastrim.

Dozimi i aditivëve

Pajisja mund të përdoret gjithashtu si pikë hyrjeje për injektimin e aditivëve kimikë në qark, për të mbrojtur sistemin.



Aksesorët



Instalimi i separatorit të papastërtive
kodi 54534..

Kodi

CBN545345




Instalimi i separatorit të papastërtive
Seria 5453.

Kodi

CBN545305

Diagrama e aplikimit



PËRMBLEDHJA E SPECIFIKIMEVE

Seria 5453 e përbërë DIRTMAG®

Separator papastërtish me magnet. Përmasat DN 20 (dhe DN 25). Lidhje F 3/4" (dhe 1") të rregullueshme (ISO 228-1). Element T tunxhi, dado mbyllëse PPSG40. Rubinet shkarkimi tunxhi me lidhje zorre. Trupi dhe kapaku i PA66G30. Elementi i brendshëm HDPE. Guarnicione hidraulike: EPDM. Mjeti: solucione uji dhe glikoli; përqindja maksimale e glikolit 30 %. Presioni maksimal i punës 3 bar. Intervali i temperaturës së punës 0–90 °C. PCT APLIKIM NDËRKOMBËTAR I PATENTËS.

Seria 5453 e përbërë DIRTMAG®

Separator papastërtish me magnet. Përmasat DN 20 (dhe DN 25). Lidhjet e rregullueshme me aksesorë ulliri për tub bakri Ø 22 mm (dhe Ø 28 mm). Element T tunxhi, dado mbyllëse PPSG40. Rubinet shkarkimi tunxhi me lidhje zorre. Trupi dhe kapaku i PA66G30. Elementi i brendshëm HDPE. Guarnicione hidraulike: EPDM. Mjeti: solucione uji dhe glikoli; përqindja maksimale e glikolit 30 %. Presioni maksimal i punës 3 bar. Intervali i temperaturës së punës 0–90 °C. PCT APLIKIM NDËRKOMBËTAR I PATENTËS.

Seria 5453 e përbërë DIRTMAG®

Separator papastërtish me magnet. Përmasa DN 20 (nga DN 20 deri DN 32). Lidhje F 3/4" (nga 3/4" në 1 1/4") të rregullueshme (ISO 228-1). Element T tunxhi i përbërë, dado mbyllëse PPSG40. Valvula mbyllëse tunxhi. Rubinet shkarkimi tunxhi me lidhje zorre. Trupi dhe kapaku i PA66G30. Elementi i brendshëm HDPE. Guarnicione hidraulike: EPDM. Mjeti: solucione uji dhe glikoli; përqindja maksimale e glikolit 30 %. Presioni maksimal i punës 3 bar. Intervali i temperaturës së punës 0–90 °C. PCT APLIKIM NDËRKOMBËTAR I PATENTËS.

Rezervojmë të drejtën për të bërë ndryshime dhe përmirësime në produktet dhe të dhënat përkatëse në këtë publikim, në çdo kohë dhe pa njoftim paraprak. Në faqen e internetit www.caleffi.com gjendet gjithmonë versioni më i përditësuar i dokumentit që duhet të përdoret për verifikimet teknike.